

Informacion mbi ofertën e re mësimore gjatë pushimeve

LiF - Të mësuarit gjatë pushimeve (Lernen in Ferien)

LiF - Të mësuarit gjatë pushimeve është një shërbim mbështetës për të gjithë nxënësit e shkollave në Rheinland-Pfalz. Qëllimi është të krijohet një ofertë mësimore gjithëpërfshirëse, lokale dhe me cilësi të lartë që plotëson mësimet e shkollës në perioda të zgjedhura pushimesh. Për këtë Landi i Rheinland-Pfalz ka fituar mbështetjen e Lidhjes së Qendrave të Arsimit të të Rriturve të Rheinland-Pfalz (Verband der Volkshochschulen von Rheinland-Pfalz e.V.) si një partner të fortë bashkëpunimi.

LiF - Të mësuarit gjatë pushimeve u ofron nxënësve mundësinë për të përsëritur përmbajtjen e mësimave dhe për të praktikuar e thelluar atë që kanë mësuar tashmë në grupe të vogla, pa presion kohe apo performance. Të gjitha kurset planifikohen sipas nevojave, d.m.th. në koordinim të ngushtë ndërmjet nxënësve pjesëmarrës, kujdestarëve të tyre ligjorë, mësuesve të tyre dhe Qendrave të Arsimit të të Rriturve (Volkshochschulen). Përveç përmbajtjes teknike, p.sh. nga lënda e matematikës, gjermanishtes ose anglishtes, fokusi i **LiF** është edhe praktikimi i aftësive ndërdisiplinore, si p.sh. aftësitë sociale.

Informacionet bazë për organizimin, zbatimin dhe vlerësimin e **LiF** janë përmbledhur në një udhëzues, i cili synon shkollat, Qendrat e Arsimit të të Rriturve (Volkshochschulen), bashkitë dhe drejtuesit e kurseve, nxënësit pjesëmarrës dhe kujdestarët e tyre ligjorë.

Pjesëmarrja në **LiF** është falas dhe me vullnet të lirë.

Si një element shtesë gjatë pushimeve shkollore, **LiF** ofron më shumë mundësi të barabarta dhe kontribuon në një përputhshmëri më të mirë të familjes dhe punës.

Informacionet kryesore rreth **LiF - Të mësuarit gjatë pushimeve**

- **LiF - Të mësuarit gjatë pushimeve** është një ofertë falas për të gjithë nxënësit e të gjitha llojeve dhe klasave të shkollave në Rheinland-Pfalz.
- Drejtuesit e kurseve nga Qendra lokale (e rrethit) të Arsimit të të Rriturve mbështesin 8 deri në 12 nxënës brenda një kursi **LiF** për praktikë, thellim njohurish dhe përsëritje.



- Temat kryesore të **LiF** koordinohen në konsultim të ngushtë ndërmjet shkollës dhe mësuesve, nxënësve pjesëmarrës, kujdestarëve të tyre ligjorë dhe Qendrave të Arsimit të të Rriturve (Volkshochschulen).
- **LiF** varet nga nevojat në vend dhe për këtë arsye mund të jetë edhe me kohëzgjatje të ndryshme. **LiF** zakonisht zhvillohet për një javë dhe përfshin tre deri në pesë mësimë në ditë.
- **LiF** ofrohet kryesisht gjatë pushimeve verore (sipas rastit edhe gjatë pushimeve të vjeshtës).
- Informacion specifik rreth **LiF** në vend, për shembull për regjistrimin, datën e ngjarjes, kohëzgjatjen dhe vendndodhjen, mund të merret nga shkolla përkatëse ose Qendra përgjegjëse e Arsimit të të Rriturve të Rrethit (Kreisvolkshochschule) ose nga Qendra e Arsimit të të Rriturve (Volkshochschule).

